



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



RR E G U L L O R E
PËR
PËRDORIMIN E GJUHËVE

Prishtinë, më 12.2.2009

Në pajtim me dispozitat e nenit 7 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve nr. 02 / L - 37, të dispozitave të nenit 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L - 040 dhe të dispozitave të nenit 32 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 455, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 12.2.2009, miratoi

RR E G U L L O R E N PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është:

- a) të rregullojë përdorimin e gjuhëve zyrtare në organet e Komunës, institucionet arsimore, institucionet e shëndetësisë dhe ndërmarrjet publike lokale;
- b) të vendosë për procedurat përmes të cilave Kuvendi i Komunës, me ndihmën e Kryetarit të Komunës, njeh gjuhët tjera zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtar në Komunë, në pajtim me nenin 2 pika 2.3 dhe 2.4 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve;
- c) të ofrojë udhëzime mbi mënyrën me të cilën përfaqësuesit komunalë, organet e administratës dhe ndërmarrjet publike lokale, do t'i përmbushin obligimet e tyre në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve në përdorim zyrtar në Komunë, siç përcaktohet me nenet: 7, 8 dhe 9 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Neni 2

Në hartimin e kësaj Rregulloreje janë përdorur përkufizimet e mëposhtme:

“Gjuhë zyrtare dhe gjuhë në përdorim zyrtar në Komunë”: Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre, janë gjuhë zyrtare në Komunë. Gjuha turke është gjuhë në përdorim zyrtar. Gjuhët e komuniteteve tjera kosovare që jetojnë brenda territorit të komunës, mund të njihen si gjuhë në përdorim zyrtar, në pajtim me kriteret e përcaktuara nga neni 2, pikat 2.3 dhe 2.4 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe procedurave të përcaktuara në nenet 4 dhe 5 të kësaj Rregulloreje.

“Komunitet”: Banorët brenda territorit të komunës, të cilët i përkasin një grupi etnik, kombëtar, gjuhësor ose religjioz, e që janë tradicionalisht banorë në territorin e Kosovës.

“Organet përfaqësuese komunale”: Kuvendi i Komunës dhe komitetet e tij.

“Organet ekzekutive komunale”: Të gjitha drejtoritë komunale dhe zyrat e tyre, institucionet komunale të shëndetësisë parësore (Qendra e Mjekësisë Familjare dhe njësitë e saja) dhe institucionet komunale arsimore, parashkollore, fillore dhe të mesme.

“Ndërmarrjet publike lokale”: Ndërmarrjet publike që ofrojnë shërbime publike në emër të Komunës së Prishtinës, siç është përcaktuar me Ligjin për ndërmarrjet publike 03/L - 087 - Lista 2 - Ndërmarrjet publike lokale të Komunës së Prishtinës.

“Obligimet e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale dhe të ndërmarrjeve publike komunale”: Çdo organ përfaqësues dhe ekzekutiv dhe ndërmarrje publike e Komunës së Prishtinës, siguron që përdorimi i gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve në përdorim zyrtar, të bëhet në pajtim me nenet: 7, 8 dhe 9 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare.

“Kërkesa për rishqyrtim”: Kërkesa për rishikim të aktit administrativ dërguar personit përgjegjës për aktin administrativ, në pajtim me nenet 126 - 136 të Ligjit për procedurën administrative 02/L- 28.

“Ankesa”: Ankesa administrative dërguar organit më të lartë administrativ në pajtim me nenet: 126 deri 136 të Ligjit për procedurat administrative.

II. KUSHTET PËR NJOHJEN E GJUHËVE ZYRTARE DHE GJUHËVE NË PËRDORIM ZYRTAR

Neni 3

3.1 Gjuha e një komuniteti, i cili, sipas rezultateve të publikuara të regjistrimit të popullsisë, përbën 5 % të popullatës brenda territorit të komunës, njihet si gjuhë zyrtare në Komunë me vendim të Kuvendit të Komunës dhe sipas Statutit të Komunës.

3.2 Gjuha e një komuniteti, i cili, sipas rezultateve të publikuara të regjistrimit të popullsisë, përbën 3 % brenda territorit të Komunës, njihet si gjuhë në përdorim zyrtar në Komunë me vendim të Komunës dhe sipas Statutit të Komunës.

III. PËRDORIMI I GJUHËVE

Shërbimet dhe dokumentet në gjuhën zyrtare

Neni 4

4.1 Përfaqësuesit komunalë, organet ekzekutive dhe ndërmarrjet publike lokale sigurojnë që secili qytetar mund të komunikojë me ta dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet publike në gjuhët zyrtare në Komunë. Për ta ushtruar këtë të drejtë, ata duhet të paraqesin kërkesë verbale ose me shkrim. Drejtoria e Administratës krijon procedura për të pranuar dhe plotësuar këto kërkesa përmes njësisë së përkthimit dhe mundësisë për përkthim simultan.

4.2 Kryesuesit, drejtorët e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive dhe ata të ndërmarrjeve publike komunale, sigurojnë që shenjat që përmbajnë emërtimet zyrtare të institucioneve të tyre, të jenë të shkruara në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunës dhe të vendosura në vende publike.

4.3 Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mbrojtjes Emergjente siguron që, brenda territorit të komunës dhe në rrugët lokale, të gjitha shenjat që tregojnë apo përmbajnë emrat e komunave, fshatrave, rrugëve apo vendeve të tjera publike, të jenë të shkruara në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunës dhe të vendosura në vende publike.

Procedurat për të kërkuar shërbime dhe dokumente në një gjuhë në përdorim zyrtar

Neni 5

5.1 Kërkesa për shërbime dhe dokumente ose për përkthime të rregulloreve komunale dhe akteve tjera në një gjuhë në përdorim zyrtar, duhet të dërgohen tek përfaqësuesit përgjegjës komunalë, organi ekzekutiv ose ndërmarrja publike. Gjatë mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, anëtarët e organeve përfaqësuese komunale, gjuha e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare e Komunës, mund të paraqesin kërkesë për shërbime të përkthimit (me gojë ose me shkrim) në Drejtorinë e Administratës, e cila duhet të sigurojë përmbushjen e saj përmes Njesisë së përkthimit.

5.2 Këto kërkesa dërgohen sipas kërkesës së përmbledhur në shtojcën 2 të Urdhëresës administrative të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr. 2007/06 mbi përcaktimin e procedurave për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Drejtoria e Administratës siguron që këto kërkesa të jenë të gatshme për të gjithë përfaqësuesit komunalë, organet ekzekutive ose ndërmarrjet publike.

5.3 Përfaqësuesit komunalë, organet ekzekutive ose ndërmarrjet publike lokale, drejtpërdrejt, ose kur është e mundur, me ndihmën e Drejtorisë së Administratës dhe të Njesisë së përkthimit, japin përgjigje në gjuhën në përdorim zyrtar, sa me shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e paraqitjes së kërkesës.

5.4 Nëse përfaqësuesit komunalë, organet ekzekutive ose ndërmarrjet publike komunale dështojnë që të sigurojnë shërbimin, përgjigjen ose dokumentin në gjuhën në përdorim zyrtar brenda 15 ditëve të punës, kërkuesi mund t'i parashtrojë kërkesë të re Drejtorisë së Administratës. Nëse pas 30 ditëve të punës nga paraqitja e kërkesës së re, shërbimi ose dokumenti nuk është siguruar, kërkuesi mund t'i drejtojë ankesë Komisionit të gjuhëve, me një kopje dërguar Drejtorisë së Administratës. Drejtoria e Administratës siguron zbatim të përshtatshëm të vendimit të Komisionit të gjuhëve.

Ankesat

Neni 6

6.1 Kërkesa për rishikim të akteve administrative ose lëshimeve që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj Rregulloreje komunale dhe me zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve nga Komuna e Prishtinës, duhet të adresohen te Drejtoria e Administratës dhe te organi komunal ose ndërmarrja përgjegjëse për akte administrative, shërbime ose lëshime me një kopje dërguar Komisionit të gjuhëve.

6.2 Shtojcat që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj Rregulloreje komunale dhe me zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Komunën e Prishtinës, dërgohen te Komisioni i gjuhëve, me një kopje dërguar Drejtorisë së Administratës dhe organit komunal, ose ndërmarrjes përgjegjëse për aktet administrative, shërbime ose lëshime.

6.3 Komuna duhet të përgjigjet dhe të marrë vendime për rishikim dhe të sigurojë zbatimin e vendimeve të Komisionit të gjuhëve mbi ankesat, në pajtim me Ligjin për procedurat administrative.

Njësia e përkthimeve

Neni 7

7.1 Drejtoria e Administratës formon dhe siguron funksionimin e Njesisë së përkthimit. Njësia e përkthimit përbehet nga : përkthyesit dhe lektori, të cilët, për punën e tyre, i raportojnë shefit të Sektorit për punë të Kuvendit dhe drejtorit të Drejtorisë së Administratës.

7.2 Drejtoria e Administratës bën vlerësime periodike të numrit të përkthyesve të nevojshëm për të bërë shërbimet e përkthimit (me shkrim dhe me gojë) në gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtar në Komunë.

7.3 Drejtoria e Administratës planifikon dhe kërkon burime buxhetore komunale për të siguruar rekrutimin, trajnimin dhe zhvillimin profesional të stafit të Njesisë së përkthimit. Drejtoria e Administratës siguron zyrë adekuate, pajisje dhe material harxhues për Njësinë e përkthimit.

7.4 Drejtoria e Administratës, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm për Shërbimin Civil të Kosovës, nxjerr përshkrimin e punëve, sqaron përgjegjësitë dhe vlerëson performancën e stafit të Njesisë së përkthimit.

Personi përgjegjës për zbatimin e përdorimit të gjuhëve zyrtare në Komunë.

Neni 8

8.1 Drejtori i Administratës është personi përgjegjës për zbatimin e përdorimit të gjuhëve zyrtare në Komunë.

8.2 Drejtori i Administratës, në bashkëpunim me drejtorët e organeve ekzekutive komunale dhe të ndërmarrjeve publike komunale, organizon teste vullnetare për të vlerësuar aftësitë gjuhësore të shërbyesve civilë, kurse vullnetare të gjuhës për të ngritur nivelin profesional të shërbyesve civilë të secilës gjuhë zyrtare dhe gjuhëve në përdorim zyrtar në Komunë. Personi kryesor për gjuhë specifikon burimet e nevojshme financiare për mbarëvajtjen e testeve gjuhësore dhe kurseve, dhe kërkon nga Kuvendi i Komunës alokimin e tyre te Drejtoria e Administratës.

8.3 Personi përgjegjës për zbatimin e përdorimit të gjuhëve zyrtare në Komunë, përgatit raport vjetor mbi zbatimin e kësaj Rregulloreje komunale dhe të Ligjit për përdorimin e gjuhëve nga ana e Komunës. Raporti i dorëzohet Kryetarit të Komunës, Kuvendit dhe Komiteti për komunitete.

8.4 Kuvendi i Komunës rishikon dhe miraton raportin bazuar në rekomandimet e Komitetit për komunitete.

8.5 Kryetari dhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës sigurojnë që raporti të publikohet në të gjitha gjuhët zyrtare dhe në gjuhën në përdorim zyrtar në Komunë, të dërgohet për diskutim publik dhe të postohet në ueb-faqen e Komunës.

Informimi Publik

Neni 9

Kryetari dhe personi përgjegjës për zbatimin e përdorimit të gjuhëve zyrtare në Komunë, organizojnë veprimtari të rregullta informuese për publikun mbi të drejtat, procedurat dhe obligimet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve dhe të kësaj Rregulloreje komunale. Veprimtaritë informuese publike bëhen në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët në përdorim zyrtare në Komunë.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 10

Kjo Rregullore mund të ndryshohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit.

Neni 11

Kjo Rregullore nxirret në gjuhët zyrtare të Komunës (gjuhën shqipe dhe serbe) dhe në gjuhën turke, në përdorim zyrtar.

Neni 12

Në rast të mospajtimeve mes dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe Ligjit për përdorimin e gjuhëve, do të mbizotërojnë dispozitat e Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Neni 13

Kjo Rregullore hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në tabelën e shpalljeve të Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINES

01. Nr. 110-286, më 12.2.2009

KRYETARI I KOMUNËS
Prof. dr. Isa Mustafa